

VENDIM
Nr.673, datë 21.5.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË
DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, BASHKIA
SELENICË TË QARKUT TË VLORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, bashkia Selenicë të qarkut të Vlorës, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 9 (nëntë), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Selenicë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

2.FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Mbështetur në inventarizimin e pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE										
Bashkia: Selenicë										
Fusha e përdorimit të pronës: pyll+kullotë										
Nr. ren.	Nr i INV sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyjore/kullosore	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërimit populllore)	Numëri i ngastrës	Destinacioni	Sip. në ha	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi juridik	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	59	Ek.P. Selenice	Bishti i malit	14	Sip.bim.pyj.	31.8	Mbrojtje toke	MMPAU	DSHP	
2	60	Ek.P. Selenice	Rruga gjemis krahu L	15	"	29	"	"	"	
3	61	Ek.P. Selenice	Fushe Selenice	16/a	"	8.5	"	"	"	
4	62	Ek.P. Selenice	Fushe Selenice	16/b	"	8.5	"	"	"	
5	63	Ek.P. Selenice	Rruga gjemise	16/c	"	6.5	"	"	"	
6	64	Ek.P. Selenice	Fushe Selenice	17/a	"	50.5	"	"	"	
7	65	Ek.P. Selenice	Fushe Selenice	17/b	"	4	"	"	"	
8	66	Ek.P. Selenice	Fushe Selenice	17/c	"	5	"	"	"	
9	67	Ek.P. Selenice	Fushe Selenice	18/a	"	10	"	"	"	

Njësia e qeverisjes vendore: bashkia Selenicë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
59-67	Sipërfaqe me bimësi pyjore	Në pronësi